

**20080821500**

**L I G J**  
**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR ORGANIZIMIN DHE PUNËN**  
**E ORGANEVE TË ADMINISTRATËS SHTETËRORE**

Neni 1

Në Ligjin për organizimin dhe punën e organeve të administratës shtetërore (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë”) numër 58/2000, dhe 44/2002), në nenin 5 në paragrafin (3), në kllapën e parë pas fjalës “drejtori” shtohet fjala “arkiv”, ndërsa në kllapën e dytë, pas fjalës “shërbimi” presja dhe fjala “arkiv” fshihen.

Neni 2

Në nenin 11, pas pikës 12, shtohet pikë e re 13 si vijon:

“13. Ministria e Shoqërisë Informatike;”

Pikat 13 dhe 14 bëhen pika 14 dhe 15.

Neni 3

Në nenin 12, paragrafi (2) alineja 4 fshihet, ndërsa alineja 5 bëhet alineja 4.

Neni 4

Në nenin 15, në alinenë 3, fjalët: “dhe për mbrojtjen civile”, fshihen.

Alineja 5 fshihet.

Alinetë 6 dhe 7 bëhen aline 5 dhe 6.

Neni 5

Në nenin 16, paragrafi (1) alineja 5 ndryshohet si vijon:

“-sigurimi i kufirit shtetëror, kontrolli i kalimit të kufirit shtetëror, si edhe çështje të caktuara që kanë të bëjnë me përcaktimin dhe zgjidhjen e incidenteve kufitare dhe cenimeve të tjera të kufirit;”

Neni 6

Në nenin 17, paragrafi (3) ndryshohet si vijon:

“(3) Byroja e ekspertizës gjyqësore dhe Drejtoria për zbatimin e sanksioneve kanë cilësinë e personit juridik.”

Neni 7

Në nenin 19, në paragrafin (2), pas alinesë 3, shtohen tri alineja të reja 4, 5 dhe 6 si vijon:

“-Byroja për Furnizime Publike;

- Drejtoria për parandalimin e larjes së parave dhe financimin e terrorizmit; dhe

- Drejtoria për policinë financiare;”

Alinetë 4 dhe 5 bëhen aline 7 dhe 8.

Neni 8

Në nenin 20, në paragrafin (1), alinetë 7, 14 dhe 15 fshihen.

Në paragrafin (2) alinetë 1, 5 dhe 6 fshihen.

Alineja 7 e cila bëhet alineja 4 ndryshohet si vijon:

“- Byroja për metrologji.”

Paragrafi (3) ndryshon si vijon:

“(3) Byroja për metrologji ka cilësinë e personit juridik.”

Neni 9

Në nenin 21, pas paragrafit (2) shtohet paragrafi i ri (3) si vijon:

“(3) Drejtoria e punëve hidrometeorologjike ka cilësinë e personit juridik.”

Neni 10

Në nenin 22, paragrafi (2), pas alinesë 1, shtohet alineja e re 2 si vijon:

“-Drejtoria për ushqim;”

Alineja 2, bëhet alineja 3.

Neni 11

Pas nenit 26, shtohet neni i ri 26-a si vijon:

“Neni 26-a

Ministria e Shoqërisë Informatike i kryen punët që kanë të bëjnë me:

- sigurimin dhe administrimin me mjetet për financimin e zhvillimit të shoqërisë informatike;
- evidentimin, koordinimin dhe përcjelljen e implementimit të projekteve të miratuara për zhvillimin e shoqërisë informatike në organet e administratës shtetërore;
- koordinimin dhe rekomandimet për implementimin e sistemeve informative dhe komunikatave në organet e administratës shtetërore;
- krijimin dhe mbajtjen e regjistrit qendror dhe evidentimin e harduerit, softuerit, pajisjes së telekomunikacionit dhe pajisjes tjetër informatike në dispozicion dhe të licencave në kuadër të organeve të administratës shtetërore;
- krijimin dhe mbajtjen e bazës qendrore të të dhënave të arritshme për format organizative informatike të organeve të administratës shtetërore;
- krijimin e politikave dhe dhënien e rekomandimeve dhe drejtimeve për implementimin e dokumenteve strategjike dhe operative për teknologjitë informative dhe të telekomunikacionit;
- organizimin e përpunimit dhe arkivimin operativ në bazë të të dhënave dhe informatave në organet e administratës shtetërore;
- koordinimin e aktiviteteve që kryhen nga ana e formave organizative për informatikë në organet e administratës shtetërore;
- koordinimin, menaxhimin dhe zhvillimin e rrjetit të integruar të sigurt të informatikës dhe komunikimit për nevojat e organeve të administratës shtetërore;
- organizimin dhe koordinimin e edukimit për rëndësinë e zhvillimit të shoqërisë informatike dhe shfrytëzimin e përfitimeve të tij për ngritjen e vetëdijes publike.
- promovimin e shfrytëzimit të shërbimeve elektronike;
- inicimin, përcjelljen dhe vendosjen e standardeve ndërkombëtare në organet e administratës shtetërore në fushën e informatikës dhe të telekomunikacioneve, aspektet e sigurisë dhe të zhvillimit të infrastrukturës;
- vendosjen, zhvillimin dhe shfrytëzimin e bazave të të dhënave dhe ndërlidhjes së tyre të ndërsjellë dhe këmbimin e informatave në mënyrë të sigurt në organet e administratës shtetërore;
- përpilimin, koordinimin dhe përcjelljen e realizimit të planeve për edukim dhe përkryerje të vazhdueshme të kuadrove në fushën e informatikës;
- realizimin e bashkëpunimit ndërkombëtar teknik dhe teknologjik;
- koordinimin dhe organizimin e specializimeve, ngritjen profesionale dhe trajnimet në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare dhe të tjera, dhe
- kryen punë të tjera të përcaktuara me ligj”.

Neni 12

Në nenin 27, në paragrafin (2) alinetë 1 dhe 2 dhe paragrafi (3) fshihen.

Neni 13

Në nenin 28, në paragrafin (2), alineja 4 dhe paragrafi (3) fshihen.

Neni 14

Me ditën e hyrjes së këtij ligji në fuqi Sekretariati i shoqërisë informatike vazhdon të punojë si Ministri e Shoqërisë Informatike.

Të punësuarit, pajisja, dokumentacioni dhe mjetet tjera të Sekretariatit të shoqërisë informatike i ndërmer Ministria e Shoqërisë Informatike.

Neni 15

Ky ligj hyn në fuqi me ditën e botimit në “Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.